

# SNV SHQIPËRI

Menaxhimi në Bashkëpunim i Pyjeve

PROJEKTI I SNV-BB

## Projekti i Zhvillimit të Burimeve Natyrore

Ngritja e Kapaciteteve të Shoqatave të reja  
dhe ekzistuese të Përdoruesve të Pyjeve  
dhe Kullotave komunale

Raport Progresi vjetor - 2007

*Janar 2008*

# SNV

Connecting People's Capacities

# SNV SHQIPËRI

## Lidh kapacitetet e njerëzve

Misioni i SNV-së është të sigurojë ndihmë teknike me qëllim lehtësimin e varfërisë dhe përmirësimin e qeverisjes për vendet më pak të zhvilluara. Qëllimi kryesor i SNV-së në Shqipëri është ta ndihmojë këtë të fundit për të zhvilluar dhe zbatuar më tej procesin e decentralizimit dhe të mbështesë qeverisjen e mirë lokale që bën të mundur lehtësimin e varfërisë në një mënyrë të qëndrueshme. Po kështu SNV-ja mbështet përpjekjet e Shqipërisë për të hyrë në Bashkimin Evropian.

Për realizimin e këtij misioni, pranohet si faktor me rëndësi jetike ndërveprimi mes qeverisjes vendore dhe organizatave të shoqërisë civile (si edhe e sektorit privat), ndërveprim ky që mundësohet përmes bashkëpunimit dhe pushtetit kundërveprues. SNV Shqipëri do të përdorë ekspertizën e saj për të përmirësuar dialogun midis autoriteteve dhe qytetarëve, për të shmangur kështu përjashtimet dhe për të realizuar shërbime më të mira për qytetarët. Për ta bërë këtë, SNV Shqipëri po fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të organizatave partnere të saj.

SNV e nisi aktivitetin e saj në Shqipëri, në 1993. SNV-ja ka aktivitet në tri zona: në qarqet e Dibrës, Fierit dhe Korçës. SNV-ja siguron shërbime konsulence për rritjen e kapacitetit, njohurive dhe qëndrueshmërisë së klientëve të saj. Shërbimet e konsulencës së SNV-së ofrohen mbi bazë të kërkesës së organeve të Qeverisjes Vendore (Komunave, Bashkive dhe Qarqeve) si dhe të Organizatave të Shoqërisë Civile. Përgjithësisht, SNV-ja përfshihet në partneritete afatgjata, por kjo nuk përjashton edhe sigurimin nga ana e saj të shërbimeve afat-shkurtra. Përhapja e eksperiencave dhe shërbimet e konsulencës në nivel kombëtar sigurohen nëpërmjet zyrës së SNV-së Shqipëri në Tiranë. Fushat ku kryesisht fokusohet SNV-ja janë Qeverisja Vendore e Përgjegjshme, Menaxhimi i Pyjeve në Bashkëpunim, Mundësia e Shfrytëzimit të Tregjeve nga të Varfërit si dhe Turizmi i Qëndrueshëm.

# SNV

Connecting People's Capacities

#### Zyra e Dibrës:

Tel: +355 218 2642/ 218 3953

E-mail: [diber@snvworld.org](mailto:diber@snvworld.org)

#### Zyra e Fierit:

Tel. + 355 342 0302/ 342 0304

E-mail: [fier@snvworld.org](mailto:fier@snvworld.org)

#### Zyra e Korçës:

Tel: +355 825 0982/ 825 3104

E-mail: [korca@snvworld.org](mailto:korca@snvworld.org)

#### Zyra e Tiranës:

Tel: +355 4 247 601/ 4 255 803

E-mail: [tirana@snvworld.org](mailto:tirana@snvworld.org)

## Përmbajtja

Lista e akronimeve	3
Detajet e projektit	4
Hyrje	4
Historiku	5
Planifikimi	6
Aktivitetet	11
Rezultatet	19
Ditët e konsultimit	21
Raporti financiar	22
SHTOJCA 1: Pasqyra e Planeve të Punës për Vitin 2007	23
SHTOJCA 2: Buxheti për Vitin 2008	24

## Lista e akronimeve

PSHP	- Projekti Shqiptar i Pyjeve
PK / APK	- Pyjet Komunale / Administrimi i Pyjeve Komunale
DPPK	- Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave
DSHP	- Drejtoria e Sherbimit Pyjor
DPPK	- (ish) Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave
SHPPKK/SHPP	- Shoqata e Perdoruesve të Pyjeve e Kullotave komunale/ Shoqata e Perdoruesve të Pyjeve
GEF	- Fondi Mjedisor Global
MMPAU	- Ministria e Mjedisit, Pyjeve, dhe Administrimit të Ujërave
SHKPK	- Shoqata Kombëtare e Pyjeve Komunale (gjithashtu: "Shoqata Kombëtare")
PZHBN	- Programi i Zhvillimit të Burimeve Natyrore (gjithashtu: "projekti i BB-së")
PPjD	- Produkte Pyjore jo Drusore
NJMP	- Njësia e Menaxhimit të projektit të BB-së
FR	- Federata Rajonale (e Perdoruesve të Pyllit)
SIDA	- Agjensia Suedeze e Zhvillimit Ndërkombëtar
SNV	- Organizata Hollandeze e Zhvillimit
BB	- Banka Botërore

# 1 Detajet e projektit

<i>ID e projektit të BB:</i>	PO82375
<i>Emri i projektit:</i>	Projekt për Zhvillimin e Burimeve Natyrore në Shqipëri - Ngritja e Kapaciteteve të Shoqatave të Reja dhe Ekzistuese, të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave
<i>Zbatuesi:</i>	Organizata Holandeze e Zhvillimit – SNV
<i>Kohëzgjatja e projektit:</i>	4 vjet – 1 korrik 2006 deri në 1 korrik 2010
<i>Financuar nga:</i>	BB/SNV me shumë totale 1,57 milion,- USD
<i>Partnerët kryesorë:</i>	Drejtoria e Politikave Pyjore dhe Kullotave (DPPK)
<i>Vendi i zbatimit:</i>	Shqipëri

# 2 Hyrje

Qeveria Shqiptare ka marrë një kredi nga Banka Botërore dhe një grant nga GEF dhe SIDA, që afërsisht arrijnë shifrën 20 milion USD, për financimin e Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU) ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për këtë Projekt, dhe Drejtoria e Politikave Pyjore dhe Kullotave (DPPK) ka përgjegjësi për zbatimin e Projektit me anën e Njësisë së Menaxhimit të Projektit (NJMP).

Komponenti i parë i projektit do të forcojë dhe rrisë përpjekjet e komunitetit për administrimin e pyjeve dhe kullotave sipas Projektit Shqiptar të Pyjeve (PSHP), i cili u mbyll në 2004-ën. Brenda këtij komponenti SNV do të zbatojë masa për ngritjen e kapaciteteve të shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe veprimet kryesore për përmirësimin e administrimit të burimeve pyjore dhe kullotave, siç është parashikuar në pikën A.3.1.

Sipas kërkesës në marrëveshjen midis Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore dhe SNV-së ky raport mbulon periudhën janar - dhjetor 2007 si dhe mbulon aktivitetet mbi programin e ngritjes së kapaciteteve të financuara nga PZHBN si është rënë dakort në Raportin e Fillimit si vazhdim logjik i aktiviteteve të vetë SNV-së në pylltarinë komunale.

**T**ransferimi I të drejtave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave për tek komunat dhe fshatrat ka filluar që në vitin 1998. 138 Shoqata Përdoruesish Pyjesh (SHPP) u krijuan gjatë Projektit Shqiptar të Pyjeve dhe 80-të SHPP u krijuan gjatë Projektit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore për administrimin e këtyre pyjeve dhe kullotave komunale. Në disa Qarqe Federatat Rajonale po krijohen duke synuar të përfaqësojnë interesat në nivele rajonale dhe kombëtare të përdoruesve të pyjeve. Në nivel kombëtar, Federatat Rajonale janë të organizuara nga Shoqatat Kombëtare të Përdoruesve të Pyjeve.

Me gjithë përmirësimin e tyre në organizata, SHKPP-të kanë nevojë të rrisin kapacitetet e tyre të përmirësojnë situatën e tyre ekonomike, të influencojnë legjislacionin për pyjet komunale dhe të jenë në gjendje të organizojnë më mirë administrimin e pyjeve komunale në nivel fshati.

Këto struktura organizative, veçanërisht Federata Rajonale, duhet të jenë në gjendje të japin shërbime speciale trajnimi SHPP-ve në lidhje me të drejtat mbi pronën, statusin ligjor, procedurat e brendshme, komunikimin dhe bashkëpunimin financiar administrimin teknik, për të pasur menaxhim të qëndrueshëm të pyjeve komunale si dhe përmirësim të vetë SHPP-ve.

Ky raport shënon fillimin e vitit të dytë të mbushur me aktivitete në ngritjen e kapaciteteve për shoqatat e përdoruesve të pyjeve në pylltarinë komunale. 2007 hasi një ecuritë të ngadaltë për shkak të vonësive në kontraktimin/zbatimin e PZHBN dhe u karakterizua nga shume misione të BB ku mori pjesë gjithashtu edhe SNV. Pavarësisht nga ky fakt SNV arriti të përfundonte marrëveshje me 10 nga 12 federatat rajonale si dhe zhvilloi trajnime në të gjitha këto rajone.

Aktivitetet mbi ngritjen e kapaciteteve të SNV të realizuara gjatë vitit 2007 përfshijnë: zhvillimin e një baze të dhënash për M&V, përfshirë një sistem monitorimi të ngritjes së kapaciteteve; një sistem menaxhimi për SHPPK/federatat; një bazë të dhënash GIS për pylltarinë komunale; si dhe program trajnimi për trajnuesit në nivel rajonal dhe përfaqësuesit rajonal dhe kombëtar të shoqatave. SNV ka zhvilluar disa module trajnimi: 5 module janë finalizuar së bashku me programin e ngritjes së kapaciteteve të PZHBN si dhe po zbatohen për SHPPK-të. Modulet prekin si aspektet organizative të shoqatave ashtu edhe njohuritë teknike të menaxhimit të pyjeve komunale.

Këshilltarët e SNV-së së bashku me një grup trajnerësh lokal në nivel komunal si dhe ndërtuesish kapacitetesh në nivel rajonal iu drejtuan terrenit për të zhvilluar trajnime (kryesisht trajnime ndërjegjësimi) si dhe vizituan 120 komuna e afërsisht 1000 fshatra, që mbulonin rreth 55% të të gjitha komunave të

planifikuara në projekt. Deri tani, pavarësisht nga ecuria e ngadaltë e zbatimit të projektit të PZHBN, procesi i gjatë i transferimit të tokave të pyjeve dhe kullotave për tek komunitat dhe mungesa e rregullave dhe dispozitave në ligjin e pyjeve, taksave dhe tarifave për të zbatuar plotësisht strategjinë e pyjeve përsa i përket menaxhimit të pyjeve në bashkëpunim; ne jemi të kënaqur me punën e bërë deri tani me Federatat Rajonale dhe Shoqatën Kombëtare të Pyjeve.

## 4 Planifikimi

Për vitin 2007, aktivitetet janë ndërmarrë në përputhje me propozimet teknike dhe planet e punës specifike për secilën federatë. Vëmendje të vecantë i është kushtuar aktiviteteve në lidhje me zhvillimin e moduleve të trajnimit, trajnimit të trajnerëve si dhe dhënies së trajnimeve në nivel fshati në përputhje me programin e trajnimit të paraqitur në raportin e fillimit. Dy muajt e parë kanë qënë fazë përgatitore ndërsa trajnimi i plotë filloi në gjysmën e dytë të vitit.

Gjatë vitit 2007 u përlogarit që do të kryheshin 1,067 ditë për këshillim (të ndara: 825 kontribut i SNV dhe 242 kontribut i PZHBN) të barasvlershme me 366,000 USD (298,500 USD SNV dhe 67,500 USD BB) kostot e këshillimit (duke përfshirë pagat, kostot e lidhura direkt me këshillimin (kostot dytësore (transport, dieta, etj.) dhe tarifatat e administrimit). Për kostot e rimbursueshme, një rezervim prej 88,000 USD është bërë për periudhën e vitit 2007.

*Të gjitha aktivitetet janë ndërmarrë në përputhje me planet e punës të mëposhtme:*

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Drejtoria e Politikave të Pyjeve dhe Kullotave	Forcimi I kapaciteteve të SHPPK-ve për të qënë efektivë dhe të qëndrueshëm në menaxhimin e pyjeve dhe kullotave komunale	<p><b>Qëllimi i detyres është:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të zhvillohet një modul mbi trajnimin e trajnerëve</li> <li>2. Të zhvillohet një seri modulesh mbi nevojat specifike të trajnimit</li> <li>3. Të ngrihet një grup rajonal prej trajnerësh lokal</li> <li>4. Të kryhet vlerësimi dhe raportimi</li> </ol> <p><b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përgatitja e programit dhe materialeve për një trajnim të trajnerëve, publikimi i 7 moduleve të trajnimit mbi trajnimet e ndërgjegjësimit, zhvillim organizativ dhe çështje teknike, organizimi i një Dite Takimi për trajnerët lokalë, raportime katërmujore, auditim financiar si dhe pjesëmarrje në misionet e BB.</li> </ul>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	252	213	15.600 Euro	11.786,08 Euro

**Shënime:** Matja e rezultateve u krye në qershor dhe janar (output). Vlerësimi outcome pritet të kryhet. Detyra të ardhshme mund të jenë të mundura mbi rishikimin e udhëzimeve mbi menaxhimin e kullotave dhe përfundimi i moduleve teknike me ndihmën e një konsulenti ndërkombëtar.

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Shoqata Kombëtare e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave	<p>Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.</p> <p>Forcimi I rrjetit dhe kanaleve të komunikimit ndërmjet SHPPK-ve dhe Federatave në të gjitha nivelet.</p>	<p><b>Qëllimi i detyres është:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ngrihen federate të reja në ato rajone ku ekzistojnë SHPPK-të</li> <li>2. Të zhvillohen trajnime mbi çështjet specifike (vetë-qëndrueshmëri financiare, lovim dhe advokaci, e të tjera..)</li> <li>3. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të Federatës</li> <li>4. Të organizohen takime bordi dhe të lehtësohet një vetë-vlerësim I shoqatës kombëtare</li> <li>5. Të ngrihet sistemi I informacionit benchmark / themelor për të gjitha SHPPK-të ekzistuese në Shqipëri.</li> <li>6. Të ndërtohen lidhje institucionale/shkëmbime në nivele rajonale dhe kombëtare</li> </ol> <p><b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ngritjen e 3 federatave, rregjistrimin e 3 federatave, 45 trajnuesve lokal të trajnuar, 11 ndërtues kapacitetesh local në federata rajonale, baza e të dhënave të SHPPK-së mbi listën e kontakteve, sistemi I monitorimit për trajnimet, konferencë mbi tokat pyjore dhe të drejtat e përdoruesve, studimi mbi zjarret në pyjet komunale, Gazeta e SHPPK-ve, stili I botimit dhe auditimi mbi përkatësinë gjinore si dhe bashkëpunimi me Misionin e BB, NJMP/PZHBN dhe AITTP.</li> </ul>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	120	102	8.400 Euro	3.305,25 Euro
<p><b>Shënime:</b> Vlerësimet Output (2) dhe Outcome të përditësuara. Detyra të ardhshme mund të përfshijnë organizimi I një seminari mbi parandalimin e zjarreve/ kontrollit dhe trajnimit të federatave në përdorimin e bazës së të dhënave monitoruese / themelore.</p>					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Dibrës	<p>Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.</p> <p>Forcimi I Federatave të Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave ne nivel kombëtar dhe komunal drejt marrjes në zotërim të menaxhimit të pyjeve të tyre në bashkëpunim.</p>	<p><b>Qëllimi i detyres është:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë</li> <li>2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të</li> <li>3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP</li> <li>4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal</li> <li>5. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të SHPPK-ve</li> <li>6. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vetë-vlerësim I federatës</li> <li>7. Të organizohen trajnime të specializuara mbi çështje strategjike</li> </ol> <p><b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnime ndërgjegjësimi në fshatrat Zall- Dardhe, Kastriot, Slllove, Tomin, Melan, Baz, Kala e Dodes, Rec, Ulez, F.Bulqize, Komesi, Shupenza, Ostren, Gjorice, vetë-vlerësime të SHPPK-ve në Kastriot dhe Rreshen, shërbime këshillimi për Federatën e Lezhës dhe Shkodrës, mbledhje e përgjithshme dhe zgjedhje të përfunduara si dhe morën pjesë aktivisht në misionet e BB.</li> </ul>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Advisory days		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Jan 2007	December 2007	122	167	6.240 Euro	3.287,56 Euro
<p><b>Shënime:</b> Vlerësimet Output (2) të përditësuara. Vlerësimi Outcome ende për t'u zhvilluar. Detyra të ardhshme mund të jenë zhvillimi I shërbimeve vetë-qëndruese ndërtimi kapacitetesh për SHPPK-të dhe Komunat.</p>					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Kuksit	<p>Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.</p> <p>Forcimi I Federatave të Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave ne nivel kombëtar dhe komunal drejt marrjes në zotërim të menaxhimit të pyjeve të tyre në bashkëpunim.</p>	<p><b>Qëllimi i detyres është:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë</li> <li>2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të</li> <li>3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP</li> <li>4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal</li> <li>5. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të SHPPK-ve</li> <li>6. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës</li> </ol> <p><b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b></p> <p>- Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Surroj, Kalis, Ujmisht, Bushtrice, Gjinaj, Bujan, Fierze, Malzi, Fajza dhe Golaj, trajnime të SHPPK-ve në Shishtavec, Terthore, Fajza, Malzi, Fajza dhe Golaj, shërbime këshillimi për Federatën e Pukës si dhe mbështetjen AITTP në përfundimin e inventarit për transferimin e pronës së pyjeve.</p>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	104	118	4.680 Euro	3.696,80 Euro
<p><b>Shënime:</b> Vlerësimi Output u përfundua në korrik. Vlerësimet Output dhe outcome ende për t'u kryer. Detyra të ardhshme mund të përfshijnë më shumë përsone si ndërtues kapacitetesh lokal.</p>					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Korcës	<p>Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.</p> <p>Forcimi I Federatave të Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave ne nivel kombëtar dhe komunal drejt marrjes në zotërim të menaxhimit të pyjeve të tyre në bashkëpunim.</p>	<p><b>Qëllimi i detyres është:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë</li> <li>2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të</li> <li>3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP</li> <li>4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal</li> <li>5. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të SHPPK-ve</li> <li>6. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës</li> </ol> <p><b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b></p> <p>- Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Gore, Pirc, Proger, Cerave, Miras, Hocsht, Miras, Barmash, Novosele, Voskopoje, Mollaj, Mollas, Qender, Cerave, Moglice, Leskovik si dhe shërbime këshillimi për Federatën e Elbasanit.</p>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	104	124	4.560 Euro	8.136,56 Euro
<p><b>Shënime:</b> Vlerësimi Output u përfundua në korrik. Vlerësimet Output dhe outcome ende për t'u kryer. Detyra të ardhshme mund të përfshijnë më shumë përsone si ndërtues kapacitetesh lokal për të punuar në Gjirokastër.</p>					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Shkodrës	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Kastrat, Postribe, Anamalit, Gruemire, Shale, Vau i Dejes, Shllak, Vigmnel, Shkrel, Gur i zi, auditim mbi përkatësinë gjinore I kryer në Gur i zi si dhe morën pjesë në një sondazh mbi arrat në Shkodër/Pukë.			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	64	47	3.360 Euro	4.324,80 Euro
<b>Shënime:</b> Vlerësimi Output ende për t'u bërë. Detyra të ardhshme mund të përfshijnë forcimin e organizimit të anëtarëve të bordit të federatës (kryesisht qartësimin të rolit të presidentit).					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Lezhës	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Orosh, Rubik, Kacinar, Rreshen, Blinisht, Kolsh, Zejmen, Kallmet, Milot, Kthelle, Ungrej dhe Balldren dhe morën pjesë në trajnimin mbi praktikën këshilluese për ndërtuesit e kapaciteteve lokal.			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	89	70	3.120 Euro	4.664,31 Euro
<b>Shënime:</b> Vlerësimi Output ende për t'u bërë. Detyra të ardhshme do të jenë të fillojnë aktivitete si ndërtues kapacitetesh lokal në rrethin e Mirëditës.					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Pukës	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullosorë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Qerret, Blerim, Rrape, Qafa e Malit, Iballe, Gjegjan dhe Fierze, trajnime të SHPPK-ve në Qerret, Qelez dhe Blerim si dhe organizimi I një mbledhjeje bordi rajonale.			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	65	47	3.120 Euro	3.649,48 Euro
<b>Shënime:</b> Vlerësimi Output ende për t'u bërë. Detyra të ardhshme do të jenë të fillojnë aktivitete si ndërtues kapacitetesh lokal.					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Tiranë-Durrës	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullororë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal 5. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Baldushk, Zall Bastar, Shengjergj, Manez, Ishem, Cudhi, Nickel, Ishem, Bubq, Berzhite dhe Vaqarr, ngritja e federatës si dhe organizimi I një mbledhjeje rajonale bordi dhe zgjedhjeve.			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	76	73	4.920 Euro	3.041,64 Euro
<b>Shënime:</b> Vlerësimi Output ende për t'u bërë. Detyra të ardhshme do të jenë të fillojnë aktivite si ndërtues kapacitetesh lokal.					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Beratit-Vlorës-Fierit	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullororë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal 5. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të SHPPK-ve 6. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Lumas, Bogove, Aranitas, Kozare, Sinje, Roshnik, Gjerbes, Cepan dhe Vertop.			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	73	29	4.920 Euro	5.457,21 Euro
<b>Shënime:</b> Vlerësimet Output u kryen në dhjetor. Detyra të ardhshme mund të përfshijnë forcimin e anëtarëve të bordit të federatës.					

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Elbasanit	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Të zhvillohen trajnime ndërgjegjësimi tek të gjitha fshatrat pyjorë e kullororë 2. Të zhvillohentrajnime mbi çështje specifike për SHPPK-të 3. Të zhvillohen trajnime për SHPPK-të, Komuna dhe DSHP 4. Të zhvillohen trajnime teknike për SHPPK-të në nivel rajonal 5. Të organizohet një mbledhje e përgjithshme me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të SHPPK-ve 6. Të organizohen mbledhje bordi si dhe të lehtësohet një vëtvlerësim I federatës <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b> - Trajnime ndërgjegjësimi në fshtrat Sult, Lenie, Pishaj, Kushove, Gjinar, Zavalin, Tregan, Stebleve, Hotolisht, Labinot Mal, Paper, Stravaj, Rajce, Lunik, Lenie, Porocan, Skenderbegas, Shushice, Labinot Mal, Paper dhe Perparim.			

Start date	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	102	61	6.960 Euro	8.167,80 Euro

**Shënime:** Vlerësimi Output ende për t'u bërë. Detyra të ardhshme do të jenë të fillojnë aktivitete si ndërtues kapacitetesh lokal (2).

Klienti	Detyra	Përshkrim i shkurtër			
Federata Rajonale e Shoqatës së Përdoruesve të Pyjeve të Gjirokastrës.	Rritja e njohurive dhe kuptimit të metodave dhe praktikave në pylltarinë komunale si dhe identifikimi I mënyrave për të përshtatur dhe vënë në praktikë këto metoda në nivel lokal.	<b>Qëllimi i detyres është:</b> 1. Asnjë  <b>Aktivitetet specifike përfshinin:</b>			
Data e fillimit	Data e mbarimit	Ditët e Këshillimit		Buxheti	
		Planifikuar	Realizuar	Planifikuar	Realizuar
Janar 2007	Dhjetor 2007	52	6	3.240 Euro	0,00 Euro

**Shënime:**  
Detyra do të fillojnë në 2008.

## 5.1. Baza e të dhënave bazë për pylltarinë komunale

SNV i ka kërkuar ECAT të japë mbështetje në hartimin e një studimi bazë për sektorin pyjor në Shqipëri (Detyra e SNV-së me Shoqatën Kombëtare të Pyjeve si pjesë e projektit të PZHBN). Në mënyrë më specifike kjo kërkesë zbatohet me anën e ndjekjes së objektivave specifike të këtij bashkëpunimi: Të mbledhë dhe hartojë një sistem informacioni të bazuar në GIS mbi informacionin shoqëror-mjedisor në Shqipëri, dhe një bazë të dhënash të bazuar në MS Access për monitorimin/vlerësimin e sistemit të Programit të Rritjes së Kapaciteteve. Nga fundi i 2007-ës, kjo bazë të dhënash u përfundua dhe ne mundëm të fillonim trajnimin e Shoqatës Kombëtare dhe Federatës Rajonale mbi mënyrën e përmirësimit dhe mbajtjes së bazës së të dhënave. Gjithashtu u vendosën lidhje institucionale me DPPK dhe INSTAT për të ndarë informacionin e duhur për monitorimin e impaktit të programit të rritjes së kapaciteteve.

## 5.2. Auditimi Financiar i projektit SNV-BB

Në fillim të 2007-ës shpenzimet kundrejt buxhetit, si dhe detyrimet financiare kundrejt pagesave u audituan nga një kompani ndërkombëtare auditimi KPMG. Kompania audituese paraqiti një raport dhe vërtetoi të gjitha shpenzimet e bëra në përputhje me objektivat e projektit duke ndjekur

# 5 Aktivitetet e Realizuara

direktivat e SNV-së. Ky raport iu paraqit gjithashtu DPPK/NJMP.

### **5.3. Redaktimi dhe botimi i 5 moduleve të trajnimit**

Gjatë muajve Janar deri Mars SNV-ja ka përfunduar shkrimin dhe redaktimin e një moduli trajnimi të trajnuesve. Përmbajtjet e këtij moduli trajnimi janë koncepte teorike bazë të komunikimit dhe reagimit, mësimit tek të rriturit, puna në grup dhe përballimi i konfliktit, si dhe drejtimi, pjesëmarrja dhe gjinia do të përdoren për të trajnuar trajnues lokalë në nivel SHPPK-je. Gjithashtu 4 module të ndryshëm për një fushatë ndërgjegjësimit mbi transferimin e pasurisë komunale, zbatimin e planeve të administrimit dhe forcimi i ekonomive të bazuara tek pyjet si mbi vetë-vlerësimin organizativ janë krijuar. Këto materiale përfshijnë fletëpalosje, materiale prezantimi, manuale, certifikata dhe postera. Një shtëpi edituese e botuese po dizajnon dhe printon 5 publikimet e ndryshme të përdorura si materiale trajnimi. 4 publikime të tjera janë në proces editimi e përkthimi. Sapo të përfundojnë këto, planifikohet të fillohet me përgatitjen e tre moduleve të reja trajnimi për vitin 2008, si dhe përfshirë hapjen e një faqeje internet për SHKP ku mund të gjenden të gjitha publikimet.

### **5.4. Hatimi i një stili botues unik për Programin e Rritjes së Kapaciteteve të PZHBN-së**

Pas një workshop-i me këshilluesit e SNV, mbi 15 këshillues me specialitete të ndryshme nga pyjet, zhvillimi dhe drejtimi i sektorit privat, kriteret e publikimit dhe elementet e një stili botues unik u përcaktuan për Programin e Rritjes së Kapaciteteve. Pritet që në vitet e ardhshëm të botohen një numër materialesh duke përfshirë manuale, CD-ROM, video, postera, letra, fletëpalosje, prezantime ne Poëer Point, programe kompjuterike, postera, reçenca, studime, etj... SNV në bashkëpunim me partnerët e projektit, Shoqatën Kombëtare të Pyjeve dhe DPPK/NJMP, si dhe sëbashku me shtëpinë e përzgjedhur botuese të përcaktojnë stilin e botimit si dhe modalitetet e tjera botuese. Një komision i përbashkët është ngritur që do të monitorojë të gjithë procesin.

### **5.5. Krijimi i 3 federatave të reja rajonale**

Me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Shfrytëzimit të Pyjeve dhe ekzekutivëve të SHPP-ve 3 federata të reja janë krijuar në rajone të ndryshme të qarqeve (Shkodër, Tirana-Durrës, Lezhë). Të tjera federata që u krijuan në 2006 (Puka, Elbasani, Berati) po mbështeten në procesin e regjistrimit të tyre në gjykatë dhe zgjedhjen e anëtarëve të rinj të bordit. Disa aktivitete paraprake janë zhvilluar për krijimin e Federatës së Gjirokastrës.

## **5.6. Nënshkrimi i Kontratave dhe Planeve të punës me 9 Federata**

Pas një procesi për identifikimin e suksesit të zbatimit të planit të administrimit të PZHBN-së, u caktua një listë me komuna ku Federata dhe SNV do të përqendrojnë aktivitetet për rritjen e kapaciteteve këtë vit. Parimi bazë ishte radhitja e aktiviteteve të NJAP me aktivitete për rritjen e kapaciteteve në rajonet ku po punojmë. Për këtë vit priten të zhvillohen trajnime në 128 komuna dhe 1085 fshatra afërsisht, duke mbuluar 60% të të gjitha komunave në përputhje me marrëveshjet dhe planet e punës të nënshkruara me 9 federata.

## **5.7. Kontraktimi i Federatës së Korçës, Kukësit dhe Dibrës dhe Shoqatës Kombëtare si Rritës Lokal të Kapaciteteve**

Duke ndjekur parimin "themel", Federatat Rajonale të Korçës, Kukësit, Dibrës dhe Shoqata Kombëtare kanë nënshkruar një kontratë me SNV-në për të ofruar asistencë dhe këshillim për SHPPK-të dhe Federatat e sapoformuara në zbatimin e Programit për Rritjen e Kapaciteteve. Federatat do të veprojnë si rritëse kapacitetesh për SHPPK-të dhe anëtarët e tyre duke u bërë trajnues lokalë efektivë që do të rrisin kapacitetet e SHPPK-ve, Komunave dhe Fshatrave. Mbi 190 ditë këshillimi janë nënkontraktuar me LBC-të të cilët do të punojnë në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me SNV-në.

## **5.8. Trajnimi i trajnerëve lokalë të Tiranë-Durrës**

Një program i vecantë trajnimi për forcimin e aftësive trajnuese të 3 trajnerëve lokalë të Federatës së Tiranë-Durrësit është përgatitur me qëllim që asnjë person nga këto rajone nuk mund të merrte pjesë në trajnimin e trajnerëve të organizuar në fillim të vitit. Kjo u zhvillua nga një grup shumëdisiplinor këshilltarësh të SNV-së.

## **5.9. Zhvillimi i trajnimeve**

Programi i trajnimeve ndërgjegjësuese përmban objektivat e PZHBN-së, procesi i transferimit dhe përgatitjes së planeve të administrimit, pjesëmarrja e komunitetit, traditat dhe kuadri ligjor në lidhje me të drejtat e përdorimit dhe administrimit të pyjeve, rolet dhe përgjegjësitë e komisioneve të pyjeve nëpër fshatra, SHPPK-ve, komunat dhe SHPQ-të. Janë zhvilluar në përputhje me shkallën e përfshirjes së tyre në zbatimin e PZHBN-së si dhe duke përdorur të njëjtën listë të komunave/SHPPK-ve të identifikuar në bashkëpunim me Federatat Rajonale dhe Njësinë e Menaxhimit të projektit PZHBN.

Ecuria e zbatimit të programit të trajnimeve për 2007 tregohet në tabelën e mëposhtme:

Grupi trajnues	Rajoni/Qarku	SHPPK-të/Komunat	Periudha
SNV Diber & Fed Diber	Diber	Zall-Dardhe, Kastriot, Slllove, Tomin, Melan, Baz, Kala e Dodes, Rec, Ulez, F.Bulqize, Komesi	Janar - Qershor
		Shupenza, Ostren, Gjorice	Korrik - Dhjetor
	Shkoder	Kastrat, Postribe, Anamalit, Gruemire, Shale	Janar - Qershor
		Vau i Dejes, Shllak, Vigmmel, Shkrel, Gur i zi, Pult, Kelmend	Korrik - Dhjetor
	Lezha	Orosh, Rubik, Kacinar, Rreshen, Blinisht, Kolsh, Zejmen	Janar - Qershor
		Kallmet, Milot, Kthelle, Ungrej, Balldren, Selite	Korrik - Dhjetor
SNV Tirana & Shoqata Kombëtare	Tirana/Durres	Ishem, Bubq, Berzhite, Vaqarr,	Janar - Qershor
		Baldushk, Zall Bastar, Shengjergj, Manez, Ishem, Cudhi, Nikel, Manez	Korrik - Dhjetor
	Berati/Fier	Lumas, Bogove, Aranitas, Kozare	Janar - Qershor
		Sinje, Roshnik, Gjerbes, Cepan, Vertop,	Korrik - Dhjetor
SNV Tirana & Korca Fed Korca & Shoqata Kombëtare	Elbasan	Sult, Lenie, Pishaj, Kushove, Gjinar, Zavalin, Tregan, Stebleve, Hotolisht, Labinot Mal, Paper	Janar - Qershor
		Stravaj, Rajce, Lunik, Lenie, Porocan, Skenderbegas, Shushice, Labinot Mal, Paper, Perparim, Kodovajt	Korrik - Dhjetor
SNV Korca & Fed Korca	Korca	Gore, Pirg, Proger, Cerave, Miras, Hocisht, Miras, Barmash, Novosele, Voskopoje, Mollaj,	Janar - Qershor
		Mollas, Qender, Cerave, Moglice, Leskovik, Hudenisht, Dardhas	Korrik - Dhjetor
SNV Kukës & Fed Kukës	Kukës	Malzi, Fajza, Golaj	Janar - Qershor
		Surroj, Kalis, Ujmisht, Bushtrice, Gjinaj, Bujan, Fierze, Tropoje,	Korrik - Dhjetor
	Puka	Qerret, Blerim, Rrape, Qafa e Malit	Janar - Qershor
		Iballe, Gjegjan, Fierze	Korrik - Dhjetor

### 5.10. Zhvillimi i trajnimeve ndërgjegjësuese mbi zbatimin e PM

Për fshatrat dhe komunat që kanë hartuar planin e tyre të menaxhimit dhe janë në procesin e zbatimit, është pregatitur një program trajnimi specifik me synimin për të forcuar kapacitetet e tyre në rregullat dhe rregulloret e PZHBN, strukturat e organizatës dhe përgjegjësitë e SHPPK-së, pjesëmarrja dhe çështja gjinore, të drejtat e antarësisë dhe përgjegjësitë dhe rolet e DSHP dhe komunës.

Sidoqoftë në sajë të vonesave në zbatimin e aktiviteteve të PZHBN, ne kemi vendosur një pjesë të këtyre trajnimeve të planifikuara

në 'pritje' derisa Njësia e Menaxhimit të Projektit të fillojë zbatimin e planeve të menaxhimit me qëllim që të përputhen aktivitetet e projektit të PZHBN. Këto trajnime ndërgjegjësuese për zbatimin e PM janë zhvilluar në komunat e mëposhtme.

Grupi trajnues	Rajoni/Qarku	SHPPK-të/Komunat	Periudha
SNV Diber & Fed Diber	Diber	Zall- Dardhe, Kastriot, Slllove, Tomin, Melan, Baz, Kala e Dodes, Rec, Ulez, F.Bulqize, Komesi	Janar - Qershor
		Shupenza, Ostren, Gjorice	Korrik - Dhjetor
SNV Kukes & Fed Kukes	Kukes	Malzi, Fajza, Golaj	Janar - Qershor
		Shishtavec, Terthore, Fajza	Korrik - Dhjetor
	Puka	Qerret, Qelez, Blerim	Korrik - Dhjetor

### 5.11. Vete-vlerësimi organizativ i SHPPKK Kastriot dhe Reshen

Funksionimi i SHPPKK-ve është një nga drejtimet kryesore të projektit të zhvillimit të burimeve natyrore. Prandaj është shumë e rëndësishme që ata dijnë se si të funksionojnë dhe si të luajnë rolin e tyre në komunitet. Vetë-vlerësimi organizativ është mbajtur për perfitimet dhe vetë-refleksionin e SHPPKK. Ky mjet vlerësimi është përgatitur nga këshilltaret e SNV bazuar në OAT ekzistuese dhe të përshtatura për kontekstin shqiptar në lidhje me pylltarinë komunale dhe SHPPKK. Të dyja këto shoqata kanë patur një aktivitet më shumë se tre vjeçar. Pritet që në muajt e ardhshëm të vazhdojë vetë-vlerësimi i organizatës në të tjera SHPPKK ekzistuese.

### 5.12. Takimi i bordit të federatës rajonale të Pukës

Federata e pyjeve e rrethit të Pukës e krijuar gjatë vitit të kaluar është relativisht e re në krahasim me federatat e Dibrës dhe Kukësit. Takimi i bordit të federatës së Pukës me mbështetjen e SNV ka diskutuar situatën aktuale në rrethin e tyre, progresin e bërë deri tani në procesin e ndërgjegjësimit në komunat e përfshira në PZHBN, nevojat e tyre, aktivitetet e lobimit dhe situatën në zbatimin e projektit. Aktivitetet e komponentit të sekuestrimit të karbonit dhe disa mangësi në hartimin e mini projekteve ishin pjesë e çështjeve të diskutuara në këtë takim. Këto shqetësime janë të njëjta me ato të rajoneve të tjera dhe këto shqetësime i janë prezantuar stafit të PZHBN në Tiranë. Për disa nga këto shqetësime ata kanë marr zgjidhjet dhe për disa të tjera çështjet janë në zgjidhje e sipër.

### 5.13. Vlerësimet e planeve të punës për 11 klientë të SNV-së

Në linjë me kontratat tona me federatat rajonale të përdoruesve të pyjeve, 11 vlerësime janë bërë me 11 klientë të SNV-së të cilët kanë marrë nga SNV këshillimin e nevojshëm gjatë gjithë

2007-ës. Në vlerësimet "Output" dhe "outcome" janë vlerësuar jo vetëm progresi, por dhe cilësia e shërbimeve të SNV-së. Vlerësimi është bërë për federatat e pyjeve të rajoneve Kukës, Pukë, Dibër, Shkodra, Lezha, Korca, Elbasan, Tirana-Durres, Berati, Shoqata kombëtare e pyjeve komunale dhe DPPK/NJMP. Të gjithë klientët e SNV-së e vlerësuar kanë rezultuar se janë të kënaqur nga shërbimet që kanë përfituar (mbi 17 pikë nga 20 pikë që është maksimumi).

#### **5.14. Auditi i çështjes gjinore në Trajnimet e Ndërgjegjësimit të PZHBN**

Një audit special u organizua në Shkodër për të identifikuar se cilat janë disa nga barrierat/arsyet kryesore që influencojnë në numrin e ulët të pjesëmarrjes së grave në trajnimet që janë realizuar deri tani në kuadrin e PZHBN. Një grup i vogël i SNV-së shoqëroi trainerët lokalë në një fshat të komunës Guri I Zi dhe përmes një vlerësimi rural të shpejtë dhe intervistave individuale analizuan situatën. Nga raporti dhe diskutimet me trajnerët lokalë gjatë një workshop në Voskopojë janë përgatitur një seri rekomandimesh për të përfshirë më shumë gratë në këtë proces, duke filluar nga çështje të tilla si mënyra e ftesës, vendi dhe përzgjedhja, barrierat kulturore, kompozimi i grupit të trainerëve etj.

#### **5.15. Trajnimi I trainerëve lokale**

Si pjesë e trajnimit të trainerëve lokalë dhe në vazhdim të trajnimit të tyre të realizuar që në fillim të këtij viti, të gjithë këta trainerë kanë marrë trajnim mujor nga këshilltarët e SNV-së dhe ndërtuesit lokalë të kapaciteteve të federatave. Përmes SNV dhe Federatave shumë nga vështirësitë dhe pengesat janë sjellë tek stafi menaxhues i DPPK. Në nëntor një sesion special refleksioni u zhvillua në Voskopojë ku të gjithë trainerët lokalë (rreth 40 në shkallë kombëtare) ndanë dhe diskutuan eksperimentet dhe mësimet e nxjerra nga puna në terren me qëllim që të përmirësojnë aftësitë trainuese të tyre, por gjithashtu të bëjnë sugjerime për NJMP dhe SNV se si të përmirësojnë punën dhe aktivitetet në kuadrin e PZHBN.

#### **5.16. Zhvillimi I aftësive këshilluese të LCB-ve**

Në të njëjtën linjë me transferimin e përgjegjësive dhe zotërimit të projektit PZHBN tek aktorët lokalë të pyjeve komunale, SNV është duke ndjekur një strategji për përfshirjen në rritje të një grupi profesionistësh nga federatat rajonale në praktikat këshilluese të SNV për klientët tanë. Gjatë gjysmës së dytë të 2007-ës rreth 10 profesionistë me përvojë shoqëruan SNV-në në trajnimin e trainerëve lokalë dhe këshillimin e SHPPKK dhe komunave në zbatimin e PZHBN. Si pjesë e zhvillimit të karrierës së tyre profesionale, progresi i tyre është monitoruar dhe vlerësuar cdo javë nga këshilltarët e SNV të cilët punojnë

bashkë me ta. Në nëntor u zhvillua një trajnim intensiv katërditor që u fokusua në aftësitë lehtësuese të praktikave këshilluese të LCB-ve (Ndërtuesit lokalë të kapaciteteve).

#### **5.17. Trajnim në aftësitë instruktuese për Këshilltarët e SNV-së**

Qëllimi I trajnimit është që pjesëmarrësit të perceptojnë të instruktuarit si dhe parimet e komunikimit që e karakterizojnë atë si një element mjaft të rëndësishëm dhe interesant të punës së një këshilltari të SNV-së. Krahas të mësuarit më shumë rreth të instruktuarit dhe komunikimit, reflektime mbi aktivitetet e PZHBN e sugjerime u bënë për NJMP dhe SNV për mënyrën si të përmirësohen aktivitetet instruktuese e trajnuese në kuadër të PZHBN-së.

#### **5.18. Lehtësimi i Mbledhjes së grupit të PZHBN**

Në tetor një workshop I vecantë u lehtësua nga DPPK dhe SNV për të përgatitur rekomandime për Misionin Special të Bankës Botërore planifikuar në nëntor 2007. Workshopi gjithashtu do të shqyrtonte kufizimet dhe mundësitë e punës, roleve dhe përgjegjësi të të gjithë aktorëve të projektit për suksesin e Programit të Zhvillimit të Burimeve Natyrore. Rezultatet e këtij workshop u paraqitën në ministri, SIDA dhe BB si inpute mbi rekomandimet si të përmirësohet menaxhimi dhe zbatimi i projektit të PZHBN-së.

#### **5.19. Raportimi tek Misioni Mbikëqyrës i Projektit**

SNV paraqiti tek misionin mbikëqyrës I projektit të BB në maj dhe nëntor 2007 aktivitetet e realizuara gjatë 2007-ës për zbatimin e programit të ndërtimit të kapaciteteve në të gjitha nivelet. Misioni ishte I kënaqur me rezultatet e SNV dhe kërkoi më shumë mbështetje për NJMP vecanërisht në lidhje me pronat dhe të drejtat e përdoruesve, taksat dhe tarifat, çështjet gjinore, menaxhimi I kullotave si dhe monitorimi I impaktit. SNV ra dakort ta prezantonte në aktivitetet e saj trajnuese në nivel lokal me SHPPKK-të, si dhe nivelet rajonale e kombëtare me kordinatorët rajonal dhe federatat e SHPPKK-ve.

#### **5.20. Asistimi per hartimin e projekt propozimit BB-AITTP**

Siç është rene dakort gjatë një misioni të BB, SNV ofroi te asistojë Agjensine e Inventarizimit dhe Transferimit te Pronave Publike (AITPP) ne hartimin e nje projekt propozimi per Banken Boterore ne kuadrin e PZHBN. Mbas nje diskutimi te gjate me Agjensine dhe Ministrine e Brendeshme, SNV dhe AITPP kane arritur te bien dakort per nje marreveshje bashkepunimi dhe nje plan pune per ofrimin e asistences teknike per organizimin e seminareve dhe trajnimeve direkte

per stafin e disa rajoneve/komunave pilot. Kjo do te realizohet ne kuadrin e bashkepunimit SNV/SIDA me synimin qe te rrisim kete eksperienece ne nje projekt propozim ne nivel kombetar (te gjithë rajonet) qe jane ne projektin e BB/PZHBN i cili mund te perfshije emerimin e stafit keshillues, lidhjet me publikun dhe reklamimin e procesit, lobimi dhe advokacine dhe teknologjine e informimit (pothuajse në përfundim). SNV mbështeti AITPP në organizimin e një workshop tre-ditor në rajonin e Kukësit në datat 20-22 nëntor me komunat që nuk kam përfunduar ende inventarin e pronave publike.

#### **5.21. Hartimi i treguesve "output" dhe "outcome" për PZHBN**

Sëbashku me grupet e URI dhe NJMP një workshop special u organizua për të skicuar arkitekturën e monitorimit dhe vlerësimit bazuar në impaktin e pritur, outcomet dhe outputet e përshkruara në document propozimin e projektit, si dhe t'i dhënë Institutit të Kërkimeve Urbane komente në mënyrë që ata të mund të përfundonin detyrën e tyre në fund të 2007. Me bashkëpunimin e Bankës Botërore skema logjike e projektit u përditësua si dhe u përcaktuan tregues të rinj inputesh, outputesh dhe outcome.

#### **5.22. Rishikimi i udhëzimeve mbi menaxhimin e kullotave për planet e menaxhimit të PZHBN**

Një tjetër kërkesë e misionit të BB ishte të përshtateshin praktikat ekzistuese me sistemet e menaxhimit fermer të kullotave në linjë me situatën aktuale dhe nevojat e përdoruesve lokalë (fermerët dhe komunitetet e tyre). Një konsulent ndërkombëtar po rekrutohet për të rishikuar udhëzimet e planeve të menaxhimit në bashkëpunim për pyjet dhe kullotat, për të ndihmuar PZHBN në zhvillimin e një serie kriteresh teknike për përmirësimin e praktikave menaxhuese të kullotave, me vëmendje të vecantë ndaj çështjeve gjinore. Konsulentit do t'i duhet të punojë në partneritet me PZHBN, Federatat dhe këshilltarët e SNV-së.

#### **5.23. Studimi në vazhdim mbi ndikimin e zjarreve ne pyjet komunale**

Qellimi i ketij studimi është qe te grumbullohet informacion per renien e zjarreve ne pyje, shfaqja dhe analiza e rreziqeve te zjarreve midis siperfaqeve pyjore te menaxhuara si pyje komunale perkundrejt atyre te menaxhuara si pyje shtetërore. Ky informacion do te jete i rendesishem per te matur efektin qe ka patur rritja e menaxhimit te pyjeve komunale dhe rritja e pjesemarrjes se komuniteteve lokale, ne parandalimin dhe kontrollin e zjarreve. Ky studim do të paraqitet dhe diskutohet me aktorët/partnerët.

Pas përgatitjes së moduleve të trajnimit dhe aktiviteteve të tjera mbështetëse gjatë katërmujorit të parë të vitit, SNV filloi intensivisht në pjesën tjetër të vitit me shumë aktivitete në terren në bashkëpunim me shumë federata. Një këshilltar tjetër SNV u kontraktua që nga 1 prill 2007 për të filluar zbatimin e programit të ndërtimit të kapaciteteve. SNV filloi zbatimin e programit të trajnimit në përputhje me komunat e përzgjedhura dhe aprovuara nga DPPK/NJMP dhe ishte në linjë me qëllimin dhe skemën e programit. SNV ishte sipas planit dhe asnjë pengesë madhore nuk ndodhi. Por kishte ankesa nga disa SHPPKK dhe komuna në lidhje me vonesa dhe procedura të tjera në procesin e kontraktimit që shkaktuan dukshëm sfidën për të realizuar aktivitetet zbatuese të NJMP me aktivitetet e ndërtimit të kapaciteteve. Pas misionit mbikëqyrës të nëntorit të BB përsëri kishte mungesë të bashkëpunimit dhe komunikimit të mirë me stafin e NJMP në aktivitetet në terren dhe përfshirjen e ulët të aktorëve lokalë të tillë si komunat, SHPPKK-të, DSHP dhe Federatat.

## 6 Rezultatet

Disa arritje të rëndësishme ishin:

- Një bazë të dhënash GIS në nivel komune u dizajnua për pylltarinë komunale (informacion mjedisor, social dhe ekonomik)
- Bazë të dhënash për Sistemin e Menaxhimit u dizajnua për SHPPKK-të dhe Federatat rajonale.
- Bazë të dhënash për list adresat e përsoneve të kontaktit, trajnerëve, anëtarëve të bordit, etj për SHPPKK-të dhe Federatat rajonale.
- Sistem monitorimi për aktivitetet trajnuese dhe të ndërtimit të kapaciteteve për SHPPKK-të dhe Federatat Rajonale.
- Raporti i auditimit financiar të projektit të SNV-BB nga KPMG
- 120 SHPPKK dhe 1080 fshatra në 10 rajone të ndryshme morën trajnim për programin e ndërgjegjesimit në nivel fshati dhe komune.
- 23 SHPPKK dhe 200 fshatra morën trajnim për implementimin e programit të ndërgjegjesimit në nivel fshati dhe komune.
- 3 Federata të reja Rajonale të Përdoruesve të Pyjeve të krijuara (Shkodra, Lezha, Tirana-Durrës)
- 3 Federata Rajonale të Përdoruesve të Pyjeve të rregjistruara (Elbasan, Puka, Berat)
- Moduli i Trajnimit të Trajnerëve u përfundua

- 4 module trajnimi për fshatrat dhe SHPPKK-të u përfundua
- U përcaktua stili i botimit për Programin e Ngritjes së Kapaciteteve të PZHBN
- 11 marrëveshje të ndryshme u nënshkruan me Federatat Rajonale të Shkodrës, Lezhës, Korcës, Elbasanit, Pukës, Kukësit, Dibrës, Beratit, Shoqatës Kombëtare me planet e punës përkatëse (shih shtojcat)
- 3 Federata rajonale po punojnë si Ngritës Lokalë Kapacitetesh dhe japin këshillim 6 rajoneve të ndryshme
- Çështjet kryesore, shqetësimet, eksperiencat dhe praktikat më të mira etj. Në lidhje me funksionimin e SHPPKK-ve si dhe menaxhimin në bashkëpunim të pyjeve dhe kullotave pasqyrohen rregullisht në gazetën related "Kurora e Gjelber".
- 2 SHPPKK kanë kryer vetë-vlerësim organizativ
- 1 Federatë Rajonale ka kryer një mbledhje bordi
- 3 Federata Rajonale, 1 Shoqatë Kombëtare dhe DPPK kanë vlerësuar planet e tyre të punës
- 3 Trajnerë lokalë kanë përfunduar trajnimin në Tiranë-Durres
- 43 trajnerë lokalë të SHPPKK-ve kanë marrë trajnime dhe po japin trajnime
- 5 modula trajnimi janë redaktuar dhe dizenuar për botim.
- 1 marrëveshje dhe plan pune është nënshkruar me AITTP
- 1 auditim mbi çështjet gjinore u realizua në federatën e Shkodrës dhe u përgatit 1 Plan Veprimesh për Çështjet Gjinore
- 2 Trajnime janë organizuar për LCB-të dhe trajnerët lokalë
- 1 trajnimi instruktimi & komunikimi u organizua për këshilltarët e SNV-së
- 2 lista rekomandimesh për përmirësimin e menaxhimit të PZHBN-së (grupi i NJMP si trajnerë lokalë të SHPPKK-ve).
- 1 Aide Mémoire PZHBN mision vlerësimi
- 1 Skemë Logjike për PZHBN me listën e treguesve të Impaktit / Outcome
- 1 terma reference për konsulent ndërkombëtar mbi menaxhimin e kullotave
- 1 studim kombëtar po zhvillohet mbi zjarret dhe pyllëtarinë komunale



## 8. Raporti Financiar

### BUXHETI I PERGJITHESHEM 2007 (USD)

	Plani	I	II	III	IV	TOTAL	
Buxheti SNV	\$298,500	\$57,138.25	\$126,819.25	\$78,712.50	\$80,970.38	\$343,640.38	115%
Buxheti WB	\$155,500	\$21,250.21	\$34,988.08	\$46,649.29	\$44,759.36	\$147,646.94	95%
<b>Total</b>	<b>\$454,000</b>	<b>\$78,388.46</b>	<b>\$161,807.33</b>	<b>\$125,361.79</b>	<b>\$125,729.74</b>	<b>\$491,287.32</b>	<b>108%</b>

### TOTAL KOSTO KESHILLIMI 2007

	Plani	I	II	III	IV	TOTAL	
Buxheti SNV	\$298,500	\$57,138.25	126,819.25	\$78,712.50	\$80,970.38	\$343,640.38	
Buxheti WB	\$67,500	\$16,662.75	21,783.75	\$14,819.50	\$11,048.13	\$64,314.13	
<b>Total</b>	<b>\$366,000</b>	<b>\$73,801.00</b>	<b>\$148,603.00</b>	<b>\$93,532.00</b>	<b>\$92,018.50</b>	<b>\$407,954.50</b>	<b>111%</b>

### PROGRAMI MBESHTETES

	Plani	I	II	III	IV	TOTAL	
1. Vleresimi nevojave/ vazhdim/ rishikim	\$3,000	\$2,306.08				\$2,306.08	
2. Analize e situates	\$2,000					\$0.00	
3. Trainim i trainereve	\$2,500		\$3,040.96			\$3,040.96	
4. Pregatitja e moduleve te trainimit	\$2,500		\$2,952.49	\$1,379.40	\$1,080.05	\$5,411.94	
5 Programe ndergjegjesimi (nivel fshati)	\$35,000	\$1,483.33	\$6,625.73	\$14,828.11	\$25,645.69	\$48,582.86	
6. Org & Teknik, trainim /coaching FUAs	\$40,500	\$798.05	\$585.14	\$12,817.95	\$6,265.45	\$20,466.59	
7. Monitorim/Vleresim	\$2,500			\$2,804.33	\$720.06	\$3,524.39	
<b>Total program mbeshtetes</b>	<b>\$88,000</b>	<b>\$4,587.46</b>	<b>\$13,204.33</b>	<b>\$31,829.79</b>	<b>\$33,711.24</b>	<b>\$83,332.82</b>	<b>95%</b>

## ANNEX 1

### Te dhena te pergjitheshme per Planet e punes per vitin 2007

Emri I Klientit	Dite te planifi-kuara 2007	Plani I punes Dite, 2007	3 mujori I dite	3 mujori II dite	3 mujori III dite	3 mujori IV dite	Total ditë	Realizuar vs Planifikuar
DPPK	252	423	14	108	22	69	213	84%
Shoqata Kobetare	136	120	37	38	10	18	102	75%
Tirana-Durres	80	76	4	7	39	23	73	92%
Berat-Vlore-Fier	58	73	1	5	14	9	29	50%
Elbasan	113	102	7	16	21	17	61	54%
Korce	74	104	32	31	36	26	124	168%
Gjirokaster	52	0	4	-	1	1	6	12%
Diber	101	122	66	54	24	22	167	165%
Kukes	76	104	38	37	35	8	118	156%
Shkoder	54	64	1	12	16	18	47	87%
Puke	21	65	4	11	31	1	47	220%
Lezhe	50	89	21	31	13	5	70	139%
Assigments	<b>1,067</b>	<b>1,342</b>	<b>229</b>	<b>349</b>	<b>262</b>	<b>217</b>	<b>1,058</b>	<b>99%</b>

Emri Klientit	Planifik. Buxhet 2007	Plani punes 2007	Shpenz. 3 muj. I	Shpenz. 3 muj. II	Shpenz. 3 muj. III	Shpenz. 3 muj. IV	Total shpenzime	Realizuar vs Planifikuar
DPPK	\$20,800.00	\$47,513.03	\$2,306.08	\$6,083.66	\$4,343.10	\$3,456.95	\$16,189.80	78%
Shoqata Kombetare	\$11,200.00	\$15,870.70	\$798.05	\$494.93	\$1,653.61	\$2,541.40	\$5,487.99	49%
Tirana-Durres	\$6,560.00	\$11,157.46	\$506.41	\$93.07	\$1,094.65	\$2,622.87	\$4,317.01	66%
Berat-Vlore-Fier	\$4,800.00	\$10,625.65		\$712.13	\$3,367.61	\$2,720.65	\$6,800.39	142%
Elbasan	\$9,280.00	\$14,025.03	\$36.49	\$2,173.19	\$4,652.06	\$4,586.66	\$11,448.40	123%
Korce	\$6,080.00	\$15,474.45	\$46.32	\$967.10	\$4,788.22	\$5,709.95	\$11,511.58	189%
Gjirokaster	\$4,320.00	\$0.00					\$0.00	0%
Diber	\$8,320.00	\$14,921.79		\$1,625.51	\$1,869.73	\$1,044.60	\$4,539.84	55%
Kukes	\$6,240.00	\$13,388.95	\$62.47	\$643.27	\$2,897.63	\$1,537.28	\$5,140.65	82%
Shkoder	\$4,480.00	\$8,415.02			\$1,911.84	\$4,305.81	\$6,217.65	139%
Puke	\$1,760.00	\$7,257.56	\$52.17		\$3,113.04	\$1,955.08	\$5,120.29	291%
Lezhe	\$4,160.00	\$12,054.22	\$779.48	\$411.46	\$2,138.30	\$3,229.98	\$6,559.22	158%
Assigments	<b>\$88,000.00</b>	<b>\$170,703.86</b>	<b>\$4,587.47</b>	<b>\$13,204.33</b>	<b>\$31,829.79</b>	<b>\$33,711.24</b>	<b>\$83,332.82</b>	<b>95%</b>

**ANNEX 2****Buxheti për vitin 2008**

<b>BUXHETI I PERGJITHESH. 2008 (USD)</b>		<b>PLANI 2008</b>				
	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>TOTAL</b>	
Buxheti SNV	50,500	58,000	58,000	48,500	<b>215,000</b>	68%
Buxheti WB	25,000	27,000	26,000	25,000	<b>103,000</b>	32%
<b>Total</b>	<b>75,500</b>	<b>85,000</b>	<b>84,000</b>	<b>73,500</b>	<b>318,000</b>	100%

<b>TOTAL KOSTO KESHILLIMI 2008 (795 days)</b>						
	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>TOTAL</b>	
Buxheti SNV	50,500	58,000	58,000	48,500	<b>215,000</b>	83%
Buxheti WB	10,000	12,500	12,500	10,000	<b>45,000</b>	17%
<b>Total</b>	<b>60,500</b>	<b>70,500</b>	<b>70,500</b>	<b>58,500</b>	<b>260,000</b>	100%

<b>PROGRAMI MBESHTETES 2008</b>						
	<b>I</b>	<b>II</b>	<b>III</b>	<b>IV</b>	<b>TOTAL</b>	
1. Vleresimi nevojave/ vazhdim/rishikim	1,000	1,000	1,000		3,000	
2. Analiza e situates					-	
3. Trainimi i trainereve	1,000				1,000	
4. Pregatitja e moduleve trainimit	1,000	1,000			2,000	
5. Program ndergjegj. (nivel fshati)					-	
6. Trainim/coaching FPUAs Org & Teknik	12,000	12,500	12,500	12,500	49,500	
7. Monitorim/Vleresim				2,500	2,500	
<b>Total programi mbeshtetes (BB vetem)</b>	<b>15,000</b>	<b>14,500</b>	<b>13,500</b>	<b>15,000</b>	<b>58,000</b>	100%